



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE DHE STREHIMIT

Kamëz, më 14 /02 2023

NJOFTIM!

Referuar ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" ligjit nr. 22/2018, datë 03.05.2018 "Për strehimin social", i ndryshuar, dhe VKM-në nr. 384, datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore"; si dhe ne zbatim të shkresës së Ministrise se Financave dhe Ekonomise me nr.13 Prot, date. 04.01.2022 "Mbi projektet e Strehimit Social per vitin 2023";

Ju sqarojmë se:

Njoftohen të gjithë qytetarët e interesuar të paraqesin aplikimet e tyre online në platformën e-albania për programin social të strehimit "Subvencionimi Interesave të Kredisë" në Bashkinë Kamez nga data 15/02/2023 deri më 28/02/2023 (*Faza e Parë*).

Programi Social i Strehimit për "Subvencionimin e Interesave të Kredisë" synon të mbështesë në blerjen e shtëpive të para, me qëllim përmirësimin e tyre të jetesës.

Kriteret bazë për paraseleksionimin e kërkesës së paraqitur nga individët/familjet e interesuara për të përfutuar nga programi social strehimit për "Subvencionimin e Interesave të Kredisë" janë:

- o individët të cilët në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë mbushur moshën 18 vjec;
- o familjet të cilat në momentin e paraqitjes së kërkesës nuk kanë në pronësi një banesë;
- o familjet që zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit bazuar në ligjin 22/2018 "Për Strehimin Social"
- o familjet që zotërojnë të ardhura brenda kufijve të përcaktuar në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr.3 - Të ardhurat minimum dhe maksimum të përfutuesve potenciale:

Struktura familjare	Struktura apartamentit	Kufiri maksimal i kredisë/familje	Te ardhurat Maksimale	Shpenzimet INSTAT 2018	Niveli minimal i të ardhurave
1- 2	Garsonier	2,600,000	93.036	46.146	26.000
3	1+1	3,120,000	111.465	62.651	26.000



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE DHE STREHIMIT

4	2+1	3,640,000	115.294	77.521	26.000
5 - 6	3+1	4,420,000	114.838	83.733	31,058

Nga programi i Subvencionimit të Interesave të Kredisë do të përfitojnë ato familje/individë që nuk disponojnë banesë në pronësi. Përparësi në përzgjedhje do të kenë:

- Çiftet e reja dhe të rinj me moshë deri në 35 vjeç;
- Individë/familje të minoritetit rom dhe egjiptian;
- Gra kryefamiljare/gra të dhunuara.

Përparësitë e përcaktuara më sipër nuk përjashtojnë individë a familje që nuk bëjnë pjesë në këto familje. Çdo individ/familje mund t'i drejtohet të treja bankave për të marrë ofertën që i përshtatet më mirë kushteve të tij/saj dhe në pas të vijojë me bankën që përzgjedh vetë.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin,

DREJTORI

Teuta CAMI